

ABU SEMAN
nr. Prot 104/P
dt 30/11/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 20 Datë 16/11/2017

Për

miratimin e lejes, për përdorim të burimit ujore të perroit të Tomorriçes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nepermjet hecit të Mivasit nga subjekti "ELVA 2001" sh.p.k në Bashkinë Gramsh Qarku Elbasan.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqeruse, afatit të vlefshmerise, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Basenit Ujore si dhe Vendimi të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencise së Basenit Ujore" Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e lejes, për përdorim të burimit ujore të perroit të Tomorriçes dege e lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nepermjet hecit të Mivasit nga subjekti "ELVA 2001" sh.p.k në Bashkinë Gramsh Qarku Elbasan.

HEC MIVAS

Burim ujore i perroit të Tomorriçes dege e lumit Devoll

Vepra e marrjes

X=4435151 Y=4507334 Z=377mxd

- Prurja mesatare 3.68 m³/sek.
- Prurja llogaritese: 4.85 m³/sek.
- Prurja ekologjike: 0.34 m³/sek

Godina e centralit

X=4433680 Y=4511633 Z=317m

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhet të plotesohen kushtet e mëposhme:

- Të mos cenoj furnizimin me uje të popullates dhe të industrise për nevojat e tanishme dhe të prespektives.
- Të zbatoj grafikun për vaditje në kohë (dite) dhe në sasi (l/s) për çdo vite të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendore dhe atë Qendrore.
- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhes kur e kërkon Bordi i Kullimit.
- Të respektoj rregullat ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN



KRYETARI I K.B.U SEMAN

